



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 476, Datë 05.10.2017

“Për zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 390, datë 22.12.2015 dhe mbylljen e hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Z. Koço BROKA	Anëtar
Znj. Iva ZAJMI	Anëtar
Znj. Leida MATJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.10.2017, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i “Raportin e hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43 pika (5) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).
Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes;
- Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE :

I- Procedura e ndjekur

- I. Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga Sektori i

Analizës dhe Studimeve “Mbi monitorimin e tregut të Gazit të Lëngshëm për konsum familjar dhe biznesin”, si dhe Relacionit së Sekretarit të Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 42, pika 1, neneve 4 dhe 9, dhe nenit 24 (shkronja d) të Ligjit Nr. 9121/2003, me anë të Vendimit Nr. 446, datë 16.01.2017 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes”, vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak.

- II. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 8, datë 16.01.2017 “Autorizim inspektorësh”, grupi i inspektimit gjatë periudhës së hetimit procedoi me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes.
- III. Në përfundim të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konkludoi se: mund të ndodhemi para një shkeljeje të mundshme të konkurrencës në tregun përkatës.
- IV. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003, me anë të Vendimit Nr. 454 , datë 21.03.2017 "Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës për konsum familjar dhe biznes", vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës për konsum familjar dhe biznes, për ndërmarrjet si vijon: "ROMANO PORT" SHA, "IB GAS" AG, "INTER-GAZ" SHA, "A&V-GAS" SHA, "AV DISTRIBUTION" SHA; "LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE" SHA (PIA), "FAM GAS" L.L.C, "KEVIN GAZ" SHA dhe "EMANUEL GAS" SHPK.
- V. Në zbatim të Vendimit Nr. 454 , datë 21.03.2017 të Komisionit të Konkurrencës, Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me Ligjin Nr. 9121/2003 dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës raportin e hetimit të thelluar.

II- Tregu Përkatës

- VI. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - 1) Tregun e produkteve
 - 2) Tregun gjeografik
- VII. Për sa i përket ngarkim/shkarkim – depozitim dhe importit në rrugë detare kjo veprimtari realizohet vetëm nëpërmjet dy porteve në zonën e ish Uzinës së Sodës PVC në Gjirin e Vlorës dhe në zonën e Porto Romanos, Durrës, porte të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë mbi bazën e marrëveshjeve të koncesionit. GLN është produkt i cili përftohen nga përpunimi i naftës bruto nëpërmjet procesit të distilimit në rafineritë e përpunimit të naftës. GLN përdoret për përfitim të nxehtësisë në kaldaja dhe për gjenerimin e fuqisë në makina/makineri, për përdorim rezidencial, etj. Llojet kryesore

të hidrokarbureve janë: benzina, dieseli, vajguri, kerosene, vajra lubrifikante, solvent dhe gazi i lëngshëm i naftës.

- VIII. Për shkak të karakteristikave që GLN-ja mbart në përfitimin e nxehtësisë për përdorim rezidencial, në industri, si karburant për automjetet, etj, si edhe të çmimeve të ulëta krahasuar me karburantet e tjera për shkak të trajtimit të ndryshëm për sa i përket taksimit në vend, GLN paraqet një zëvendësueshmëri të ulët nga ana e kërkesës konsumatore.
- IX. Në këto kushte, vlerësojmë se tregu përkatës i produktit në këtë rast është:
- a- *Tregu i ngarkim – shkarkimit të GLN-së;*
 - b- *Tregu i depozitimit të GLN-së;*
 - c- *Tregu i importit GLN-së;*
 - d- *Tregtimin me shumicë të GLN-së.*
- X. Shërbimet e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit nëpërmjet rrugës detare ofrohen nga Porti Vlora -1 në Vlorë (këtu e në vijim Vlora-1) dhe Porto Romano në Durrës, (këtu e në vijim Porto Romano), lidhur me mënyrën e funksionit të secilit port si dhe bazuar në marrëveshjet koncesionare secili nga portet vlerësohet si treg përkatës gjeografik i veçantë.
- XI. Përsa i përket importit dhe tregtimit me shumicë të GLN-së ndërmarrjet nën hetim zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pra treg përkatës gjeografik do të konsiderohet *tregu i brendshëm*.

III- Struktura e Tregut të Gazit të Lëngshëm të Naftës (GLN)

- XII. Importi dhe tregtimi i GLN-së në territorin e Republikës së Shqipërisë funksionon si një treg i liberalizuar për sa i përket aktivitetit të importit, por kjo veprimtari realizohet vetëm nëpërmjet dy porteve të naftës në zonën gjeografike të ish Uzinës së Sodës PVC në Gjirin e Vlorës dhe në zonën gjeografike të Porto Romanos, Durrës, porte të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë mbi bazën e marrëveshjeve të koncesionit.
- XIII. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.454, datë 21.03.2017 dhe analizës së informacionit të grumbulluar gjatë hetimit rezulton se ndërmarrjet nën hetim ushtrojnë veprimtarinë sipas niveleve të mëposhtme:
- ***Në nivelin e parë (ngarkim-shkarkim dhe depozitim)*** bëjnë pjesë ndërmarrjet Romano Port, Intergaz; IB GAS, PIA, Fam Gas.
 - ***Në nivelin e dytë (importi)*** bëjnë pjesë ndërmarrjet e importit A&V GAS dhe KEVIN GAS.
 - ***Në nivelin e tretë (tregu i shitjes me shumicë)*** bëjnë pjesë ndërmarrjet e tregtimit me shumicë të GLN të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Ligjin Nr. 8450/1999 “Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre”. Këto ndërmarrje themelohen në formën e shoqërive aksionare dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të GLN vetëm pas pajisjes me licencë tregtimi. Këto shoqëri kanë të drejtë të themelojnë apo të marrin pjesë në shoqëri

të tregtimit me pakice të GLN, si stacione të shitjes së karburanteve apo njësi të lendeve djegëse.

iv. **Tregu i Ngarkim-Shkarkimit dhe Depozitimit të GLN-së**

- XIV. Nga të dhënat e administruara gjatë procedurës së hetimit rezulton se në zonën e Romano Port ekzistojnë 3 (tre) impiante depozitimi të produktit GLN. Ndërmarrja Intergaz disponon në pronësi XXX depozita me kapacitet XXXX m³ të cilat ia ka dhënë me qira për një afat 3 (tre) vjeçar ndërmarrjes IB Gas shoqëri aksionare e regjistruar sipas legjislacionit të Zvicrës.
- XV. Në Portin Vlora- 1, aktualisht ekzistojnë dy depozita me kapacitet rreth XXXX m³ secila pra në total rreth XXXX m³, të cilat janë në pronësi të koncesionarit PIA. Që prej vitit 2014 këto depozita i janë dhënë me qira ndërmarrjes Fam Gas, ndërmarrje e regjistruar në Kosovë dhe e cila operon në zonën e lirë doganore në portin Vlora-1 duke qenë një kompani e peregjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Shqipëri.

IV.1 Sjellja e Ndërmarrjeve Romano Port dhe PIA

- XVI. Ndërmarrja Romano Port në zonën gjeografike të portit Porto Romano ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit të produktit të GLN-së. Në bazë të kontratës koncesionare tarifave e aplikuar nga kjo ndërmarrje miratohen paraprakisht nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA).
- XVII. Ndërmarrja PIA, e cila ka marrë me koncesion portin Vlora-1, në bazë të marrëveshjes koncesionare ofron shërbimin e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN. Pra, importuesit e GLN-së, në bazë të marrëveshjes koncesionare gjejnë shërbim të plotë për ngarkim-shkarkim dhe depozitim, shërbim që në bazë të marrëveshjes koncesionare në Portin Vlora-1 ofrohet nga PIA, e cila është e detyruar t'ua ofrojë këtë shërbim në bazë të tarifave përkatëse, duke i trajtuar operatorët në kushte të barabarta.
- XVIII. Për sa më sipër, të gjithë ndërmarrjet importuese të licencuara për ushtrimin e tregtimit të GLN-së, të cilat nuk kanë ndërtuar depozita pranë portit të Porto Romanos, kanë një mundësi tjetër për importin e GLN-së në rrugë detare nëpërmjet portit Vlora-1.
- XIX. Në zonën gjeografike të portit Porto Romano gjatë periudhës nën hetim kanë ushtruar aktivitetin e ngarkim-shkarkimit dy ndërmarrje A&V GAS dhe Alb-Durazzo, si dhe një ndërmarrje e re në këtë treg (Al Gaz). Ndërsa në portin Vlora-1 ka ushtruar aktivitetin e ngarkim-shkarkimit vetëm ndërmarrja Fam Gas.
- XX. Nga analiza e të dhënave të administruara rezulton se sasia e GLN-së së përpunuar nëpërmjet porti Porto Romano është më e madhe se sasia e përpunuar në portin “Vlora 1”, përkatësisht rreth 45% e sasisë totale të importuar të GLN-së përpunohet në portin Vlora 1 dhe rreth 55% e sasisë në portin Porto Romano.
- XXI. Nga të dhënat e administruara, konstatohet se ndërmarrja Romano Port nuk i ka ndryshuar tarifave të shërbimeve të ofruara përgjatë periudhës 2015 – 2016 – 2017, si tarifave të aplikuar për ngarkim-shkarkimin e GLN-së ashtu edhe tarifave të administrimit dhe informimit të saj. Tarifave të ndërmarrjes Romano Port miratohen paraprakisht nga OSHA dhe nuk mund të ndryshohen në mënyrë të njëanshme nga vetë ndërmarrja.

- XXII. Ndërmarrja PIA ka aplikuar tarifa të shkallëzuara gjatë vitit 2015 sipas sasisë së përpunuar të produktit të GLN-së, ndërsa që prej vitit 2016 ndërmarrja PIA ka aplikuar tarifë të unifikuar dhe më të ulët krahasuar me periudhën e mëparshme lidhur me shërbimin e ngarkim-shkarkimit.
- XXIII. Referuar sa më sipër vërehet se ndërmarrjet Romano Port dhe PIA aplikojnë tarifa të ndryshme lidhur me përpunimin dhe administrimin e produktit të GLN-së.

v- **Tregu i Importit të GLN-SË**

- XXIV. Një nga kriteret kryesore, që përcaktojnë pozitën dominuese në treg është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun përkatës. Përvoja e vendeve të Bashkimit Evropian udhëzon, që pozita dominuese nuk është e mundur nëse pjesa e tregut përkatës të ndërmarrjes është më e vogël se 40%. Eksperiencia sugjeron se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrja zotëron një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit
- XXV. Struktura e tregut të importit të gazit tregon se ndërmarrja A&V GAS, e cila ka patur pjesë tregu mbi rreth XX% gjatë viteve 2012-2014, ka pësuar rënie gjatë dy viteve të fundit, duke mbërritur në XXX% të tregut të importit të GLN-së për vitin 2016. Ndërsa për periudhën janar-shkurt 2017, pjesa e kësaj ndërmarrje është rreth XXX%.
- XXVI. Ndërmarrja KEVIN GAS ka rritur ndjeshëm pjesën e saj të tregut duke mbërritur në XXX% të tregut të importit të GLN-së gjatë vitit 2016 nga XXX% që ishte sasia e importuar për produktin GLN të kësaj ndërmarrje në vitin 2015. Volumet sasiore të importuara nga ndërmarrja Kevin Gaz krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 janë rritur me XXX% dhe vazhdojnë të jenë të larta duke arritur në rreth XXX% për muajt janar-shkurt 2017.
- XXVII. Në përfundim të analizës së pjesëve të tregut, bazuar në udhëzimin mbi pozitën dominuese të ndërmarrjeve në treg dhe praktikave më të mira të Komisionit Evropian, rezulton se ndërmarrja A&V GAS e ka humbur pjesën e tregut që zotëronte në periudhën 2011-2015 dhe nuk e plotëson kriterin e pjesës së tregut për t'u vlerësuar si ndërmarrje me pozitë dominuese.
- XXVIII. Në bazë të të dhënave të administruara dhe analizuara rezulton se ndërmarrja A&V GAS ka humbur XX % të pjesës së tregut të importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së për vitin 2016, kurse ndërmarrja KEVIN GAZ ka fituar XX % të totalit të tregut të importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së në vend për vitin 2016, si edhe ka pasur një rritje me XX % për sa i përket aktivitetit të saj krahasuar me vitin 2015. Paqëndrueshmëria e pjesëve të tregut për tre vitet e fundit, (A&V GAS – XX % në 2014, XX% në 2015, XX% në 2016) (KEVIN GAZ - XX% në 2014, XX% në 2015 dhe XX% në 2016), jep një panoramë të qartë se nuk jemi para dominancës kolektive.
- XXIX. Gjithashtu, një ndërmarrje e re është futur në treg në Dhjetor të vitit 2015 AL Gaz, me një pjesë tregu prej XX % për vitin 2016.
- XXX. Ndërmarrja KEVIN GAZ është bërë furnizues i disa prej ndërmarrjeve më të mëdha të nivelit të dytë të tregtimit, si grupi Kastrati, Petrol Gas, Andkri, Mega Gas etj., të cilët gjatë periudhës 2014 - 2015 kanë qenë furnizuar nga ndërmarrja A&V GAS.

- XXXI. Bazuar në praktikat më të mira të OECD-së dhe rasteve të Komisionit Evropian, mbi abuzimin me pozitën dominuese kolektive, ndryshimi i madh i pjesëve të tregut, paqëndrueshmëria e tyre në vite, ndryshimi i burimeve të furnizimit të ndërmarrjeve, ndjekja e politikave të ndryshme të çmimit, janë prova që nuk jemi para një dominancë kolektive të 2 (dy) ose më shumë ndërmarrjeve.
- XXXII. Nga krahasimi i çmimeve mesatare mujore të shitjes së ndërmarrjeve importuese dhe shitëse me shumicë A&V GAS dhe KEVIN GAS me bursën PLATZ për periudhën hetimore maj 2015 deri në shkurt 2017 rezulton se këto ndërmarrje kanë reflektuar trendin e Bursës PLATZ.
- XXXIII. Ndërmarrjet importuese dhe shitëse me shumicë "A&V GAS" SHA dhe "KEVIN GAS" SHA për periudhën nën hetim maj 2015-shkurt 2017 kanë çmime të ndryshme blerje dhe aplikojnë çmime të ndryshme shitje nga njëra-tjetra me diferenca domethënëse për produktin e GLN-së në këtë nivel, krahasuar këto me të ardhurat bruto të realizuara nga shitja e produktit GLN për secilën nga këto ndërmarrje.
- XXXIV. Gjatë procedurës së inspektimit në ndërmarrjet nën hetim nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2013. Gjithashtu, sjellja e ndërmarrjeve ndaj çmimit të shitjes, duke aplikuar çmime të ndryshme me diferenca domethënëse për këtë treg, nuk përbën shenja të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 3, pika 4 dhe nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2003, si dhe Metodologjisë së OECD "Për zbulimin e karteleve me evidenca indirekte" në formën e një marrëveshje të ndaluar/praktike të bashkërenduar midis këtyre ndërmarrjeve.
- XXXV. Referuar pasqyrave financiare, treguesit EBITDA për periudhën 2013 - 2015 dhe marzhet bruto e të ardhurave për periudhën objekt hetimi tregojnë se nuk jemi përpara normave të fitimeve jo normale ose eksesive të cilat janë tregues të një tregu që vuan nga mungesa e konkurrencës.

VI- **Tregu i Shitjes me Shumicë**

- XXXVI. Në këtë nivel tregtimi janë përfshirë ndërmarrjet e blerjes dhe shitjes me shumicë të produktit të GLN-së në vend që e blejnë produktin kryesisht pranë ndërmarrjeve importuese ose në disa raste importojnë vetë duke e blerë produktin në magazinë të lirë doganore.
- XXXVII. Tregu i blerjes me shumicë të GLN-së nga importi përballet me kushte dhe çmime konkurrionale, ku konstatohet se kemi një lëvizje të vazhdueshme të blerësve nga njëri importues tek tjetri në varësi të diferencave në çmime që këta importues mund të aplikojnë. Ndryshimi i furnitorëve (importuesve) nga ana e ndërmarrjeve që blejnë me shumicë GLN, është pranuar edhe nga ana e përfaqësuesve të ndërmarrjeve gjatë inspektimeve, por edhe konstatohet nga faturat e blerjes së periudhës hetimore.
- XXXVIII. Nga analiza konkludohet se nuk jemi para çmimeve të fiksuara në shitje në nivelin e tregtimit me shumicë. Çmimet e shitjes variojnë nga njëra ndërmarrje tek tjera, por duke ndjekur trajektoren e çmimeve të rritura të shitjes, transferuar nga çmimet e bursës PLATZ tek importuesit edhe më pas tek kjo kategori tregtimi.
- XXXIX. Nga të dhënat vërehet se ka pasur rritje të pjesëve të volumit të sasive dhe të pjesëve të

tregut të ndërmarrjes AV Distribution gjatë vitit 2016, në krahasim me atë 2015, dhe rritje e konsiderueshme e pjesës së tregut për periudhën janar-shkurt 2017, ku pjesa e kësaj ndërmarrje ka arritur në rreth XX %.

- XL. Ndërmarrja Emanuel Gas ushtron aktivitetin në nivelin e tregtimit me pakicë, me të drejtë për të shitur direkt tek konsumatorët fundorë. Kjo ndërmarrje e ka filluar aktivitetin e tregtimit të GLN-së në muajin shtator 2015. Bazuar në të dhënat e shitjeve të ndërmarrjes KEVIN GAZ, rezulton se ndërmarrja Emanuel Gas ka realizuar blerje në sasi që janë në nivele dukshëm më të vogla se ato të realizuara nga ndërmarrjet e nivelit të tregtimit me shumicë.
- XLI. Nga analiza konkludohet se nuk jemi para çmimeve të fiksuara në shitje në këtë nivel tregtimi. Çmimet e shitjes variojnë nga njëra ndërmarrje tek tjera, por duke ndjekur trajektoren e çmimeve të rritura të shitjes, transferuar nga çmimet e bursës PLATZ tek importuesit edhe më pas tek kjo kategori tregtimi.

VII- Problematikat e funksionimit të tregut

- XLII. Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin Nr. 390, datë 21.12.2015 ka vendosur mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës dhe dhënien e rekomandimeve për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Financave.
- XLIII. Gjatë procedurës hetimore ka rezultuar se në treg vazhdon shitja në mënyrë direkte nga shitësit me shumicë tek konsumatori fundor (biznes ose familjar) duke shmangur hallkën e shitjes me pakicë të GLN-së.

Bazuar sa më sipër rezulton se:

1. Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të hetimit në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit produktin gaz i lëngshëm i naftës për konsum familjar dhe biznes, rezulton se nga ndërmarrjet nën hetim nuk ka shkelje të Ligjit Nr. 9121/2013.
2. Nga hetimi rezultoi se rekomandimet e dhëna me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 390, datë 22.12.2015 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës dhe dhënien e rekomandimeve për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë” nuk janë vënë në veprim nga Ministria.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Operatorit Shtetëror të Autorizuar, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave:
 - 1- Miratimin e një metodologjie për rregullimin e tregut e cila të përcaktojë në mënyrë të

qartë rolin, funksionet dhe mënyrën e funksionimit të çdo operatori që vepron në fushën e importit, ngarkim-shkarkimit, depozitimit, shitjes me shumicë, shitjes me pakicë dhe shpërndarjes së gazit të lëngshëm natyror;

- 2- Zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 390, datë 22.12.2015 dhe rekomandimeve të dhëna si vijon:
 - a. Të ndërmarrë veprimet e nevojshme për mirëfunksionimin e segmenteve të tregut të importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së në përputhje me nenin 14, 15 dhe 16 të Ligjit Nr. 8450, date 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.
 - b. Të ndalohet ndërmarrjet e shitjes me shumicë të GLN-së të shesin me pakicë tek klientët fundor të cilët nuk janë të përfshirë në nenin 14 të Ligjit Nr. 8450, date 24.02.1999.
 - c. Të ndalohen ndërmarrjet e tregtimit me pakicë të GLN-së që të tregtojnë produkt për njësi të tjera që kanë si objekt rishitjen e këtij produkti siç parashikohet në nenin 16 të Ligjit Nr. 8450, date 24.02.1999. Njësitë e shitjes me pakicë të GLN-së duhet të tregtojnë produkt vetëm për konsumatorët fundor.
- II. Ndërmarrjet nën hetim, Operatori Shtetëror i Autorizuar dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të njoftojnë pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi zbatimin e rekomandimeve të mësipërme brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- III. Monitorimin nga ana e Autoritetit të Konkurrencës të të gjitha segmenteve të tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes, për një periudhë 1 (një) vjeçare, e cila fillon nga data 16 tetor 2017.
- IV. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara dhe monitorimin e tregut.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS